



EMIGRACIONI NDRYSHOJNE PROCEDURAT

Nga data 11 dhjetor 2006, ndryshojnë shumë gjëra për emigrantët.

ÇFARË NDRYSHON;

- ndryshojnë procedurat dhe formularët për disa lloj kërkesash që zakonisht bëheshin në Kuesture.
- Ndryshon mënyra e;
- rinovimit të lejeqendrimit të përkohshëm (permesso di soggiorno)
 - kërkimit të kartës së lejeqendrimit (carta di soggiorno)
 - ndryshimit të të dhënave mbi lejeqendrim ose mbi kartën e lejeqendrimit
 - procedura të tjera

Emigrantet NUK DUHET TË SHKOJNE MË NË KUESTURË për të bërë kërkesat e mësipërme, por duhet të drejtohen në postë.

Emigrantët duhet të drejtohen në postat e autorizuara, të tërheqin falas zarfin (kit) e duhur për rinovimin e lejeqendrimit të përkohshëm, për kërkimin e karts së lejeqendrimit ose për korrigjime të ndryshme mbi lejeqendrim. Pasi të keni plotësuar formularët e kërkuar dhe bashkëngjitur dokumentat që kërkohen, duhet ti postoni duke paguar shifrën e vendosur nga ligji (30 Euro+ pullën). Në momentin e postimit posta duhet t'ju dorëzojë një fature (ricevuta) që vërteton paraqitjen e kërkesës nga ana juaj. **Kujdes; personi i interesuar duhet të paraqitet vetë në postë për të postuar zarfin.**

ÇFARË NUK NDRYSHON:

NUK ndryshon procedura për :
Bashkim familjar
Praktikat në vijim e sipër

Çfarë bën CISL-i, ANOLF-i dhe INAS-i

Çdonjeri mund të zgjedhë që të plotësojë dokumentat vetë ose të kërkojë ndihmë, CISL-i, ANOLF-i e INAS-i përse i përket ndryshimit të procedurave (rinovimin e lejeqendrimit, kërkesës për kartë lejeqendrimi, korrigjimeve të ndryshme) **kanë organizuar NJË SHËRBBIM ME PRENOTIM për të kryer një shërbim sa më të mirë me anë të konsultimit dhe asistencës për emigrantët që duhet të rinovojnë lejeqendrimin e tyre.**

INAS-i është i autorizuar nga Ministria e Brendshme për dërgimin e kërkesave me anë të kompjuterit, kështu që kur kërkesa, që gjithsesi duhet dërguar me postë arrin në destinacion, është e pranishme në sistemin informatik dhe kjo ndihmon evitimin e shumë gabimeve.

Takimi mund të merret në dy mënyra:

Duke telefonuar në numrin: 0303844695

Ose duke u paraqitur personalisht në zyrën e prenotimit të CISL –it në via Altipiano d'Asiago 3 Brescia

Për takim telefononi çdo ditë nga e Hëna në të Premte
nga ora 9.00 – 12.00 dhe nga ora 15.00 deri në orën 18.00

Takimet bëhen për të gjitha degët ku ndodhemi dhe është aktiv ky shërbim:

BRESCIA, DESENZANO D.G., GAVARDO; GARDONE VT, CHIARI, PALAZZOLO SO., ORZINUOVI, MANERBIO, MONTICHIARI.

Ky shërbim i drejtohet të gjithë personave që banojnë në provincën e Brescia-s, kurse për procedurat që nuk ndryshojnë mund të kontaktoni ANOLF-in.

Brescia, 1 dhjetor 2006